



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 175 Prot.

Tiranë, më 07 / 03 / 2013

Lënda : Dërgohen rekomandime për ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar.

Drejtuar : **Z. EDUARD HALIMI**
MINISTËR I DREJTËSISË

TIRANË

I nderuar zoti Ministër !

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*" për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin dhe bazuar në kompetencën që i jepet në bazë të shkronjës "ë", të pikës 1, të nenit 32, të këtij ligji, për t'i bërë rekomandime çdo autoriteti për ndryshime ligjore, rekomandon disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*", të ndryshuar.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Këto ndryshime synojnë zbatimin e parimit të barazisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe njëkohësisht synojnë të adresojnë angazhimet e marra nga shteti shqiptar në kuadër të Rekomandimit CM/Rek (2010)5 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftës kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, i miratuar nga Komiteti i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës më 31 mars 2010 në takimin e 1081-të. Ndryshimet e propozuara janë bërë duke mbajtur parasysh edhe praktikën më të fundit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Pasi jemi njohur nëpërmjet faqes zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë me projekt – ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, rekomandojmë sa më poshtë:

Një prej parashikimeve që bëhet në shtojcën e Rekomandimit CM/Rec (2010)5, pjesa e I-rë “E drejta për të jetuar, për siguri dhe mbrojtje nga dhuna”, gërma “A” “Krimet e urrejtjes” dhe incidente të tjera të motivuara nga urrejtja”, konkretisht në pikën 2, konstatohet se tashmë është adresuar në projekt ligj, nëpërmjet nenit 6 të tij, duke ndryshuar gërmën “j” të nenit 50 të Kodit Penal, rekomandimi që bëhet për të parashikuar motivin tentencioz të lidhur me orientimin seksual ose identitetin gjinor si rrethanë rënduese në përcaktimin e sanksioneve. Përfshirja në riformulimin që i është bërë gërmës “j” të nenit 50 të Kodit Penal, nëpërmjet ndryshimeve të propozuara në projekt -ligj duke parashikuar si rrethana rënduese edhe shkaqet e tjera të parashikuara edhe në ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është veçanërisht pozitive.

Për të adresuar parashikimet e tjera të bëra në Rekomandimin CM/Rec (2010) dhe për të garantuar të drejtën për siguri dhe mbrojtje nga dhuna të personave për shkak të orinetimit seksual apo identitetit gjinor të tyre, propozojmë që pas nenit 84/a të Kodit Penal, të riformulohet ose të shtohet një nen tjetër me qëllim parashikimin si figurë të veçantë vepre penale të kanosjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit.

Për të adresuar parashikimet që bëhen në pjesën e I-rë të Rekomandimit CM/Rec (2010), gërma “B” “Fjalimet e urrejtjes”, ku parashikohet se : “Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme për të luftuar të gjitha format e shprehjes të cilat mund të kuptohen në mënyrë të



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

arsyeshme se prodhojnë efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër lesbikëve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve, duke përfshirë median dhe internetin”, propozohet që të riformulohen ose të shtohen nene të reja pas nenit 119/a “Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik” dhe 119/b “Fyerja me motive racizmi ose ksenofomie nëpërmjet sistemit kompjuterik” në mënyrë që të kriminalizohet shpërndarja e materialeve homofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik dhe fyerja nëpërmjet sistemit kompjuterik për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit.

Ashtu siç kemi theksuar dhe më lart Rekomandimi, kërkon me forcën ndalimin dhe dënimin publikisht të “gjuhës së urrejtjes”. Praktika më e fundit e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka e ka vendosur diskriminimin për shkak të orientimit seksual në të njëjtin nivel dhe rëndësi, me diskriminimin për shkak të racës, origjinës ose ngjyrës. Këtë konkluzion ka arritur GJEDNJ-ja në çështjen *Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë* (Çështja nr. 1813/07, datë 09 shkurt 2012) ku thekson se : “diskriminimi në bazë të orientimit seksual është po aq serioz sa diskriminimi për shkak të “racës, origjinës, ose ngjyrës”.

Në këtë vendim GJEDNJ-ja ka bërë referim duke ju rikthyer një tjetër çështje të gjykuar prej saj, çështja *Féret kundër Belgjikës*, (çështja nr. 15615/07, 16 korrik 2009) çështje në të cilën GJEDNJ ka bërë interpretime të rëndësishme, duke cituar këtu: “..... nxitja e urrejtjes nuk nënkupton domosdoshmëri thirrje për kryerjen e akteve të dhunës apo ndonjë akti tjetër të paligjshëm. Sulmet ndaj grupeve të veçanta të popullsisë të kryera nëpërmjet fyerjes, talljes apo shpifjes, mund të jenë të mjaftueshme për autoritetet për të përligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste, përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme.....”

Për këtë arsye propozojmë që në seksionin e III-të të Kodit penal, të titulluar “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”, pas nenit 265 “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”, të shtohet një nen për të kriminalizuar nxitjen e urrejtjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit të tyre gjinor.

Rekomandimi CM/Rec (2010)5 kërkon që shtet anëtare të sigurojnë që ti kushtohet një vëmendje e veçantë hetimit dhe incidenteve të motivuara për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit, kur ato pretendohet të jenë kryer nga zyrtarët e zbatimit të ligjit,



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

ose persona të tjerë që veprojnë në funksionin e tyre zyrtar dhe që persona përgjegjës për veprime të tilla të çohen efektivisht përpara drejtësisë dhe të marrin dënimin e duhur.

Propozojmë që neni 253 “Shkelja e barazisë së shtetasve” të riformulohet në mënyrë që të përfshihen edhe shkaqe të tjera të parashikuara nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” duke përfshirë këtu orientimin seksual dhe identitetin gjinor të personit, duke garantuar një mbrojtje më të gjerë të personave ndaj shkaqeve diskriminuese, për të cilat një punonjës me funksion shtetëror apo në shërbim publik mund të bëjë dallime ndaj shtetasve duke shkelur në këtë mënyrë parimin e barazisë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al